

“VICTORIA INVEST INTERNATIONAL” SH.P.K.

PERMBLEDHJA JO-TEKNIKE

*Shesh Grumbullim
Qarku Kukes*

GUSHT 2021

PERMBAJTJA

- a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
- c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- ç)një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
- d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
- dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
- e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
- ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
- f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar
- g) mbetjet që gjenerohen gjatë funksionimit të aktivitetit

Të përgjithshme.

Raporti i Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (VNM) ka siguruar nje mbledhje te te dhenave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e Projektit, perfshire kushtet fizike, atmosferike, burimet ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social ekonomike te zones. Ne hartimin e studimit perdoret informacioni, te dhenat ekzistuese, se bashku me standardet dhe normat e aplikueshme per te vleresuar ndikimet potenciale mjedisore, specifike dhe sociale te fasiliteve te propozuara. Ndikimet potenciale mjedisore te shqyrtuara dhe analizuara ne kete VNM, perfshijne ndikimet ndaj cilesise se ujit, burimeve nentokesore ujore, situates social-ekonomike, kulturore gjate zhvillimit te projektit dhe te aktiviteve lokale te pritura.

Burimet e vleresuar social-kulturore perfshijne punesimin, perdorimin e tokes, transportin dhe sherbimet e komunitetit te zones. VNM percakton masat zbutese per te parandaluar ose minimizuar gjate aplikimit te ndikimeve mjedisore dhe sociale te projektit te propozuar. Keto raportohen ne detaje ne planin e menaxhimit te mjedisit, i cili eshte pjese e studimit. Vleresimi i ndikimit ne mjedis perbehet nga teresia e procedurave te veprimit, monitorimit, zbutjes dhe masave institucionale, qe do te zbatohen gjate Projektit per te eliminuar, kompensuar apo pakesuar ndikimet e kunderta potenciale mjedisore dhe sociale.

Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM)

I percaktuar me fjale te thjeshta, VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar.

Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimet dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdesi veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te veprimeve te propozuara.
- Te promovojë zhvillimin miqësor dhe te qëndrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis.

Zhvillimi i Qendrueshem eshte nje koncept kyç qe ka marre nje perhapje dhe pranim nderkombetar gjate dy dekadave te fundit. Agjenda 21, dhe plani global per zhvillimin e qendrueshem, theksojne rendesine e vendimarrjes se integruar te mjedisit dhe te zhvillimit dhe promovimin e VNM dhe instrumenteve dhe politikave te tjera per kete qellim.

Klasifikimi i projektit:

Në bazë të ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i nënshtrohet Raportit Paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Legjislacioni mjedisor

Baza Ligjore	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011	Për lejet e mjedisit
Ligji Nr.9362, datë 24.03.2005	Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve
Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura I ndryshuar me: - Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
Ligji Nr.10081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë
Ligji Nr.7875, datë 23.11.1994	Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë” I

	ndryshuar me: Ligjin Nr. 9219 datë 08.04.2004
Ligji Nr.9385, datë 04.05.2005	Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, I ndryshuar me: Ligjin Nr. 9791 datë 23.07.2007
Ligji nr. 8770, datë. 19.04.2001	Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike i azhurnuar
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmës në mjedis
Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001	Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin
Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001	Për emergjencat civile
Ligji Nr. 7643, 09.12.1999 I ndryshuar	Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror
Ligji Nr.9379, datë 28.04.2005	Për efikasitetin e energjisë
Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003	Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta i ndryshuar me :Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009
Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe Marrëveshje të ndryshme. Ndër to përmendim:	
Ligji Nr. 9672, datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimmarrje, si dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.
Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos në konventën për ndryshimet klimatike (UNFC).
Vendime të Këshillit të Ministrave	
VKM Nr. 13, datë 4.01.2013	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis.
V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006	“Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor
VKM Nr.123, datë 17.2.2011	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis.
VKM Nr. 587, datë 7.07.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike.
VKM Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror
VKM Nr.804, datë 4.11.2003	Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje.
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse.
VKM Nr.435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.
VKM Nr.803, datë 4.12.2003	Për standardet e cilësisë së ajrit.
VKM Nr.247, datë 30.04.2014	Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore
VKM Nr.114, datë 27.01.2009	Për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Udhëzime dhe Rregullore	
Udhëzimi Nr. 1037/I, datë 12.04.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre.
Rregullore	
Rregullorja Higjeno-Sanitare datë.17.11.1997	Për pastrimin në zona urbane dhe rurale, administrimin dhe trajtimin e mbeturinave
Rregullore, Nr.I, datë 30.03.2007	Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre

Territori ku ndodhet sheshi I grumbullimit është kryesisht me reliev kodrinor. Lartësitë me te mëdha ne zone janë lartësite 800 m. Kuota me e ulet ne zone është 645 m. Sheshi i grumbullimit ka nje siperfaqe prej I ha dhe kufizohet nga keto koordinata :

Koordinatat sipas: Albanian 1986/Gauss-Kruger Zona 4		
PIKAT	Y	X
1	4444626.5	4658774.4
2	4444754	4658774.4
3	4444782.6	4658773.9
4	4444786	4658746.9
5	4444646.6	4658664.3

Koordinatat sipas KRGJSH		
PIKAT	X	Y
1	527267.8	4658477.2
2	527395.8	4658478.7
3	527423.8	4658478
4	527428.1	4658451
5	527289.1	4658367.4

Siperfaqja e zones se kerkuar eshte I ha

a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;

Zona me interes për shfrytëzim (referuar hartës së studimit të florës) paraqitet relativisht e zhveshur e mbuluar me bimësi të pakët, kryesisht shkurre të vogla dhe e ekspozuar ndaj agentëve klimatike. Si rezultat i vëzhgimeve në terren të zones, janë identifikuar habitate të ndryshme sipas NATURA 2000 dhe konkretisht:

92C0 Pyje me rrap (*Platanus orientalis*) dhe *Liquidambar orientalis* (*Platanion orientalis*);

5210 Shkorretë me *Juniperus* spp.;

9170 Pyje dushku dhe shkoze të karakterizuara nga asoc. *Galio-Carpinetum*;

Sipërfaqja e vendburimit është pothuajse tërësisht e zhveshur, me pak pyje lisi, të përzier me halorë e me shkurre, nuk është tokë bujqësore dhe mbi të nuk ka vepra të mbrojtura me ligj.

Në shpatet me pjerrësi më të madhe se 50 % bimësia është e pazhvilluar dhe e rrallë. Nëpër rrjedhat e proskave sezonale ku akumulohen depozitime dhe sedimente të shkrufta vërehen individë të rrallë të dushqeve dhe dëllinjës së kuqe. Zhvillim më i plotë i shoqërimeve shkurre vërehet në shpatet me pjerrësi nën 30%, zona në të cilët janë akumuluar depozitimet e shkrufta proluviale.

Sipas klasifikimit të përgjithshëm fitosociologjik të bimësisë së Shqipërisë shoqërimet bimore të zonës në studim i përkasin asaj të dushqeve gjetherënës. Ky brez shtrihet mbi brezin e shkurreve mesdhetare mbi lartësinë 1000m.

Zona në studim mbizotërohet nga vegjetacioni i dushkajave, një grupim bimor i cili përfaqëson pyje gjethegjëra të përhapura përgjithësisht në brezin para malor dhe malor.

Ky shoqërim bimor gjendet më shpesh në toka të kafenja tipike. Speciet më karakteristike të këtij shoqërimi janë shparthi (*Quercus frainetto* Ten.) dhe qarri (*Quercus cerris* L.), të cilët janë edifikatorë të fitocenozës dhe lloje dominante njëkohësisht, të cilët dallohen për shkallën e lartë të sasi-mbulesës e dominancës.

Dushkajat e formuara nga dushqe mezofile dhe gjysëmmezofile janë pyje me hijezim më të madh se sa ato të formuara nga dushqet kserofile kështu që edhe flora e tyre është më pak e pasur. Përbërja floristike ndryshon sipas tipit të pyllit, përbërjes së tokës, lartësisë, kundërdrejtimit, shkallës së ndriçimit etj., por një numër i konsiderueshem specimesh janë të përbashkëta.

Sipërfaqja në studim mbulohet në 50% të saj nga llojet mezofile të qarrit *Quercus cerris*, shparthit *Q. Frainetto*, shoqëruar me dëllinjën së kuqe *Juniperus oxycedrus* dhe me përfaqësim më të rrallë ato të shkozës *Carpinus orientalis* Mill, frashërit *Fraxinus ornus* L, panjës *Acer campestre*, pishës së butë *Pinus* sp (sb. *pinia*) dhe drizës *Paliurus aculeatus* etj.

Shoqërimi shfaqet përgjithësisht i dëmtuar me pjesë të caktuara në stadin e filizërisë. Në çelirat e krijuara pas prerjes së dushkut përhapet masivisht dëllinja e kuqe *Juniperus oxycedrus*, ndërsa në sipërfaqet e hapura livadhore evidentohen zhvillimi i qumështores *Euphorbia myrsinites*. Llojet e tjera që takohen në hapësirat e hapura të zonës së studimit janë manaferra *Rubus ulmifolius* Schott, fiku i egër *Ficus carica*, trëndafili i egër *Rosa canina* L, driza *Paliurus spina-christi* Mil, murrizi *Crataegus monogyna*.

Për nga përbërja floristike e katit të florës barishtore përfaqësohet nga llojet: *Potentilla erecta*, *Lychnis coronaria* L, *Buglossoides purpureo-caerulea* (L.) I.M. Johns., *Clinopodium vulgare* L, *Brachypodium pinnatum* (L.) P.B., *Lathyrus niger* (L.) Berhn L. *Stachys germanica* L, *Dactylis glomerata* L, të cilat janë specie karakteristike të aleancës *Quercion frainetto-cerris* por të përhapura janë edhe llojet e *Achillea millefolium* L., *Bellis perennis* L, *Ajuga reptans*, *Geranium robertianum*.

Lista e llojeve floristike më të zakonshme në zonën e studimit

1. *Quercus frainetto* Ten.
2. *Quercus cerris* L.
3. *Pinus* sp (sb. *pinia*)
4. *Juniperus oxycedrus*

5. *Fraxinus ornus* L,
6. *Acer campestre*
7. *Carpinus orientalis* Mill.
8. *Buxus sempervirens*
9. *Euphorbia myrsinites*
10. *Pteridium aquilinum*
11. *Rubus ulmifolius* Schott.
12. *Rosa canina* L.
13. *Paliurus spina-christi* Mill
14. *Crataegus monogyna*
15. *Paliurus aculeatus*
16. *Ficus carica*
17. *Buglossoides purpureocaerulea* (L.)I.M.Jhons.,
18. *Clinopodium vulgare* L.,
19. *Brachypodium pinnatum* (L.)P.B.,
20. *Lathyrus niger* (L.)Berhn ,
21. *Stachys germanica* L
22. *Dactylis glomerata* L
23. *Achillea millefolium* L.
24. *Bellis perennis* L,
25. *Ajuga reptans*,
26. *Geranium robertianum*.



b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;

Duke qenë në vendburim janë mjaft të zhvilluara tektonika e pasmineralizimit dhe fenomeni i çarshmërisë, janë krijuar kushtet dhe janë hapur rrugët për kalimin, depozitimin dhe rrjedhjen ujrave nëntokësore të tipit të çarjeve. Linjat tektonike dhe sistemi i çarjeve shërbejnë për të drenuar edhe uji i poreve. Janë ujra të lira, pa presion, prurja e të cilëve varet nga sasia dhe intensiteti i reshjeve atmosferike.

Gjatë dimrit dhe sidomos gjatë pranverës, kur shkrihet dëbora, përrenjtë e rrëketë fryhen shumë me sasi të konsiderueshme ujrash sipërfaqësore, gjë që rrit ndjeshëm intensitetin dhe prurjen e ujrave nëntokësore nëpunimet minerare, sa që nganjëherë e bën të pamundur vazhdimin normal të punës. Në verë reshjet pakësohen e përrenjtë thahen. Ndryshimi i shpejtë i prurjeve të ujrave nëntokësore, në varësi të sasisë dhe intensitetit të reshjeve, flet për komunikimin hidraulik të sistemit të çarjeve dhe linjave tektonike.

Ujrat nëntokësore janë të tipit karbonatik, me PH 7,5 deri 8,5, shumë të mira për t'u pirë kur nuk ndoten nga faktorët artificialë.

Burimi ujore me i afert me zonen e projektit është Liqeni i zi i Valikardhes që ndodhet në Lindje të zones dhe Liqeni i Bardhe që ndodhet në Veri të zones.

Për sa thamë, arrijmë në përfundimin se vendburimi ka kushte të thjeshta hidrogeologjike. Ujrat nëntokësore janë kryesisht të sistemit të çarjeve, që kanë komunikim hidraulik, por dhe të porozitetit, dhe për pasojë kanë regjim tepër të ndryshueshëm, vartësi të reshjeve.

Siç dihet masivin ultrabazik të Bulqizes e ndan në dy pjesë lugina e Vajkalit, ku mes për mes kësaj lugine kalon zalli i Bulqizes, i cili vazhdon në drejtim të lindjes dhe tek Ura e Çerenecit Shupenze takohet me zallin e Okshtunit dhe vazhdojnë rrugën deri sa takohen me lumen e Drinit të zi në veri të fshatit Gjorice. Krahas këtyre lumenjve kryesore rajoni përshkohet edhe nga disa perrenj të tjere siç janë perroi i Thate, perroi i Helmit etj.

Krahas këtyre perrenjve dhe lumenjve në zonen tone kemi edhe dalje të ujrave nëntokësore nga galeritë e minierave si të Bulqizes, Almarines, Traverbangeve të Kreshtes etj.

Ujrat nëntokësore që burojnë nga galeritë e kromit të Bulqizes janë ujra të çarjeve dhe si rrjedhim kanë një shpërndarje jo të njëtrajtshme.

Prurjet e ujit, që ushqehen nga ujrat sipërfaqësore, janë në varësi të thellesisë së punimeve e të tektonikës dhe janë me të mëdha në kohë me reshje dhe gjatë shkëmbinjes së debore. Prishjet dhe zonat tektonike në disa raste shërbejnë si ujembledhës për drenimin e ujrave të çarjeve të zones për rreth tyre.

Prurjet e çarjeve të veçanta lidhen me njëra tjetren me zhvillimin e punimeve.

Studimet e para hidrogeologjike në vendburimin e kromit të Bulqizes janë kryer gjatë viteve 1957 dhe 1960, të cilat janë paraqitur në raportin gjeologjik të vitit 1960. Në këtë studim jepen të dhëna kryesisht mbi trajtimin; regjimin e ujrave nëntokësore të shkëmbinjve ultrabazik mbi ujedhenien e galerive, por mungojnë punimet speciale hidrogeologjike për vlerësimin e vetive filtruese të shkëmbinjve që ndertojnë këtë vendburim.

Me vonë gjatë viteve 1966-1977 në pjesën qendrore e veriore të vendburimit të Bulqizes u kryen studime hidrogeologjike për të sqaruar ujembajtjen e depozitimeve kuaternare të lugines së Vajkalit dhe lidhjen e tyre me shkëmbinjte ultrabazik në sektorin e shfrytëzimit. Gjatë vitit 1977 ish Ndermarrja Hidrogeologjike e Tiranës në bashkëpunim me Ndermarrjen Gjeologjike të Bulqizes bëri një studim me qëllim parashikimin e prurjeve të mundshme të ujit në traverbankun Klos-Bulqize, që u hap rreth kuotes + 400 metra mbi nivelin e detit. Punimet e këtij studimi përmbajnë rilevim hidrogeologjik, shpime, pompime etj, të cilat vertetuan edhe njëherë se zona e poshtme hidrokinamike e shkëmbinjve ultrabazik përmban ujra në sasia të konsiderueshme të cilat në traverbankun në fjalë mund të arrijnë deri në disa qindra litra/sek.

Të dhënat me interesante mbi ujrat nëntokësore të shkëmbinjve ultrabazik i kanë dhënë traverbanket që janë hapur në masivin e malit të Dhoksit nga ana e Bulqizes (zona D) dhe nga ana e Batres.

Ujrat nentoksore qe burojne nga galerite jane ujra te çarjeve dhe si rrjedhim kane nje shperndarje jo te njetrajteshme. Prurjet e ujit , qe ushqehen nga ujrat siperfaqesore , jane ne varesi te thellesise se punimeve e te tektonikes dhe jane me te medha ne kohe me reshje dhe gjate shkrires se debore. Prishjet dhe zonat tektonike ne disa raste sherbejne si ujembledhes per drenimin e ujrave te çarjeve te zones per rreth tyre.

Prurjet e çarjeve te veçanta lidhen me njera tjetren me zhvillimin e punimeve.

Shkembijnjte ultrabazike te masivit te Bulqizes pershkohen nga nje rrjet i dendur çarjesh , prishjesh dhe zonash tektonike.

Ujrat e ultrabazikeve ne pergjithesi jane ujra te embla , pa ngjyre , pa ere dhe pa shije , te tipit hidrokarbonat magneziumi , me mineralizim te pergjithshem 0.30-0.40 gr/lit , me fortesi te pergjithshme te ujit 9.5-II grade gjermane , PH = 8.2 e me shume.

c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;

Ne zbatimin e ketij projekti nuk do te kete ndonje ndikim te madh ne mjedisin ne teresi dhe kryesisht ne ajer. Kryerja e punimeve ne kete projekt nuk shoqerohet me emetime kimike, per rrjedhoje nuk kemi te bejme me perqendrimet dhe ndikim te tyre ne mjedis. Disa nga ndikimet e mundeshme ne ajer por qe jane minimale, mund te theksojme:

- Ndertimi i rrugeve
- Shkarkim i sasive minimale te gazeve nga automjetet dhe makinerite qe punojne me karburant.
- Krijimi i sasive te pluhurit si pasoje e qarkullimit te makinave gjate transportit te materialeve te ndryshme.

Gjate procesit te punes pluhurat mund te konsiderohen si problem gjate stines se thate te veres e kur fryjne erera te thata te cilat ndikojne ne ngritjen e pluhurit, gjithashtu pluhurat jane si mundesi edhe gjate shkarkimit dhe manipulimit te materialeve. Por kjo eshte e perkoheshme.

Gjate stineve me lageshti keto pluhra nuk perbejne shqetesim pasi jane ne sasira te vogla.

Konkretisht, ne mbare vendin, verehen ndertime me konstruksione betoni e hekuri, te cilat nuk jane ne harmoni me natyren dhe pejsazhin perreth.

Subjekti qe do te marre kete siperfaqe ne perdorim, do ti neneshtrohet zbatimit te te gjithe legjislacionit shqipar qe eshte ne fuqi per; pyjet, mjedisin, turizmin, territorin, zonat e mbrojtura etj.

Aktivitetet qe do behen ne siperfaqen e dhene ne perdorim, ne asnje rast nuk parashikojne veprimtari qe te demtojne burimet ekzistuese natyrore ne zone (prerje druresh, krastije e pa autorizuar, punim toke, ndezje zjarresh, ndryshim të destinacionit të fondit pyjor etj).

Gjithsesi, subjekti do të duhet të pajiset edhe me leje mjedisore lidhur me aktivitetet e parashikuara.

Në rast se do të konstatohen demtime të drurëve perreth (tharje, djegie, prerje e tyre, krasitje e pa autorizuar etj), per shkak te zhvillimit të këtij aktiviteti, AdZM Tirane do të ndërmarre veprimet përkatëse. Zevëndesimi i drurëve apo dëmtimeve që behen në siperfaqen pyjore do të kompensohen permes investimeve në ate siperfaqe ose në ndonjë siperfaqe tjetër që e cakton AdZM Tirane (vendin dhe sasi e punës që duhet kryer).

Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne toke.

	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
I	Shqetesim i shtreses se tokes per shkakte te qarkullimit te makinerive	Gjenerim i nje sasie te vogel dheu e cila grumbullohet per nje perjudhe te vogel kohore

2	Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe automjeteve te transportit si kamione etj.	Ngjeshja e tokes nga levizja e automjeteve
3	Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes	Ndotje e tokes si pasoje e rrjedhjes se lubrifikanteve dhe karburanteve dhe per shkak te vellimit jo te madh te punimeve e numrit te reduktuar te makinerive, ndotja do te jete minimale
4	Vibracion si pasoje e levizjeve te makinerive	Gjykuar nga volumi i punimeve do te jete nje vibracion normal teknologjik

Ndikimet direkte te veprimtarise ne faune, flore dhe habitatet e zones

E gjithë zona dallohet për biodiversitetin e habitateve dhe pasurinë e flores dhe të faunes. Shume prej tyre janë të vëra për shkak të rrallesise se tyre lokale, kombetare ose nderkombetare, si p.sh ariu i murrmë (*Ursus arctos*). Në afërsi të korijeve e rreth fshatrave vërehet ujku (*Lupus canis*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), kunadhja (*Martes foina*), baldosa (*Meles meles*); në rrethinat e dendura të pyllit dhe afër tokave bujqësore, vërehet derri i egër (*Sus scrofa*), lepuri i egër (*Lepus europaea*); në lëndina, korije e burime ujore, kullotin sorkadhet (*Capreolus capreolus*). Kullotat alpine janë shprehje e habitatit ku rriten shume bime të rralla të zones kryesisht bimësia barishtore, për vet natyrën e këtij shoqërimi, karakterizohet nga gërshetimi i florës së pyjeve të ahut e të rrobullit dhe të kullotave alpine. Llojet më të pranishëm konsiderohen *Saxifraga rotundifolia*, *Fragaria vesca*, *Salvia glutinosa* dhe shumë bimë aromatike, mjekësore e tanifere, duke veçuar çajin e malit, e kultivuar në një pjesë të kesaj sipërfaqeje.











Kohet e fundit është vënë re rritje e ndjeshme e derrit të eger (*sus scrofa*), kjo dhe për shkak të ndalimit të gjuetisë apo moratoriumit të vitit të kaluar.

Në kreshtat shkembore sipër sipërfaqes janë të vendosura shume fole shqiponjash të cilat mund të vezhgohen lehtësisht me dylbi.

	Ndikimi i mundshëm	Pasoja në mjedis
I	Shqetësim i faunes në zone	Sipërfaqja ku do të kryhen punimet është e varfer në bimesi dhe rrjedhimisht proceset ekologjike janë minimale dhe të kufizuara. Fakti që në zone zhvillohen shume aktivitete, na jep të drejte të themi se nuk do të kemi ndonjë shtim apo demtim habitatit e ekosistemesh të virgjera. Disa procese që lidhen me shume me shqetësimet dhe cilesinë e mjedisit, do të ushtrjnë ndikimet e tyre në botën e gjallë sidomos do të mbajnë larg zones disa lloje shtazore

Ndikimet direkte te veprimtarise ne burimet ujore, hidrologji dhe cilesine e ujerave ne zone

Zbatimi i ketij projekti, duke pasur parasysh vendin ku zbatohet projekti, nuk do te kete ndonje ndikim ne ujrat siperfaqesore e nentokesore. Ne siperfaqe e propozuar per zbatimin e keti projekti nuk ka dhe nuk kalojne ujra te cilat mund te ndikohen si rezultat i zbatimit te ketij projekti.

Lloji i ndikimeve ne uje	Identifikimi i ndikimit			
	Gjate ndertimit		Gjate punimeve	
	Po	Jo	Po	Jo
Trajtimi i ujerave te ndotur				
Ndotja e ujit prej pluhurit, acideve, derdhjeve aksidentale dhe substancave te tjera				
Ndikimi sekondar ne ndotjen e ujit per toka bujqesore, ujerat nentokesor etj.				
Modifikim ne drenazhimin e ujerave natyrore				
Ndotja e ujerave siperfaqesor dhe nentokesor nga llumrat				

Ndikimet direkte ne kushtet klimatike dhe cilesine e ajrit te zones

	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet	Sasia e gazeve NO ₂ dhe SO ₂ qe do te shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara.
2	Sasi pluhuri si pasoje e qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te mineralit	Ky fenomen do te jete me i dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesojte kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle

Ndikimet direkte ne nivelet e zhurmës se zones

Persa i perket niveleve te zhurmave nga zbatimi i projektit verejme se gjate operacioneve te ndryshme te punes siç eshte transporti, kemi te bejme me nivele zhurmash qe nuk i kalojne normat e lejuara.

	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
1	Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes	Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe.

Ndikimet direkte ne veçorite e peizazhit

	Ndikimi i mundshem	Pasoja ne mjedis
I	Ndikime ne pejsazh dhe topografine e terrenit ku ndodhet objekti	Nder ndikimet me evidente do te ato vizuale te pejsazhit. Gjithashtu ndikime do te kete edhe ne zhvillimin e proceseve te tokeformimit etj. Zhveshja e siperfaqes vetem brenda kordinatave te kontrates.

Identifikimi i ndikimeve te mundeshme nga mbetjet e ngurta.

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat me mjedis
I	Gjenerim i mbetjeve te ngurta nga aktiviteti njerezor.	Ndotje urbane, dhera, etj.

ç)një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për t'u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer, sidomos mbi burimet natyrore të parinovueshme.

Industria minerare është shumë e rëndësishme në ekonominë e një vendi, por ajo shoqërohet edhe me ndikime mjedisore negative të cilat në disa raste mund të jenë të pashmangshme. Shumë prej ndikimeve negative mjedisore mund të minimizohen përmes një planifikimi të kujdesshem mjedisor dhe aplikimit të teknikave dhe teknologjive së parandalimit të ndotjeve.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjeneruara, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Bazuar në tipin e aktivitetit ndikimet më thelbësore mund dhe duhet të analizohen sipas fazave të veprimtarisë, konkretisht,

- në fazën përgatitore/instalimeve/rikonstruksionit dhe kryerjes së punimeve të reja
- në fazën e mbylljes, rehabilitimit të objekteve dhe riaftësimit të proceseve natyrore.

Është e rëndësishme të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve:

- *Ndikime të kthyeshme në mjedis*
- *Ndikime të pakthyeshme në mjedis*

Te dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Punimet do të kryhen kryesisht me mjete krahu dhe me eskavator.

Emetimi i zhurmave gjatë këtyre punimeve llogaritet gjithashtu të jetë në vlera të pa rëndësishme. Shkarkimet e mundshme nga proceset e punës janë:

- Grimcat e ngurta nga proçesi i levizjeve të dherave, nga qarkullimi i mjeteve të transportit në sipërfaqe që gjenerojnë pluhra.
 - Gazet të cilat vinë nga djegia e karburanteve të mjeteve të punës
 - Zhurmat nga puna motorike e mjeteve të punës si dhe nga procesi i ngarkim-shkarkimit të mineralit.
- Veprimtaria nuk parashikon asnjë proces teknologjik, të pa nevojëshme për kete veprimtari.
 - Është lehtësisht i aksesueshëm nga automjete e kompanisë zhvilluese.

Sipas O.B.SH. percaktohet kjo norme e lejuar per zhurmat :

Kohezgjatja e ekspozimit	Niveli i zhurmave ne dB
8 ore	85 dB
6 ore	92dB
4 ore	95 dB
3 ore	97 dB
2 ore	100 dB
1-1,5 ore	102 dB
1 ore	105 dB
0,5 ore	110 dB
0,25 ore	115 dB

Per nivel zhurme mbi 85 dB aplikohet detyrimisht mbrojtja e vesheve me mjete mbrojtese. Punonjesit qe jane ne ekspozim nen 100 dB kalojne ne kontroll shendetesor per shkalle degjimi cdo vit, ndersa per ekspozim mbi 100dB, kontrolli behet cdo 6 muaj.

Per momentin shkarkimet gazore vijne vetem nga makinerite. Koha e pranise se ketyre gazrave eshte shume e shkurter e si pasoje nuk influencon ne mjedisin e punes.

Normat e lejuara për pluhurat në ajrin e frymëmarrjes, pa përmbajtje SiO₂ është si më poshtë (neni 231 i Rregullores):

Nr	Llojet e pluhurave	Përqëndrimi i lejuar i këtij lloje pluhuri në ajër në mg/m ³
1	Pluhur azbesti	2
2	Pluhur çimento-argjile	5
3	Pluhur qymyri	5
4	Oksid hekuri	5
5	Nikel dhe oksidet e tij	0.5

Normat e lejuara për pluhurat në ajrin e frymëmarrjes me përmbajtje SiO₂ janë si në tabelë :

Nr	Përmbajtja e SiO ₂ në % për pluhurat e ajrit të ambjentit	Norma e lejuar e këtij lloji pluhuri në mg/m ³
----	--	---

1	0.5	5.00
2	10	3.80
3	20	3.70
4	30	3.65
5	40	3.60
6	50	3.55
7	Mbi 50%	3.40

d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

Ndikimet negative të identifikuara me lart do të jenë gjatë gjithë kohës së zhvillimit të këtij aktiviteti. Ato mund të jenë me të dukshme gjatë stinës së verës pasi edhe mundësia e shkarkimeve në këto periudha është më e madhe. Megjithatë duhet theksuar se proceset e punës janë në një kohëzgjatje jo të madhe dhe shkarkimet në mjedis janë minimale.

Bazuar në kontratën e qerases e bërë ndërmjet paleve zhvillimi i këtij aktiviteti do të jetë deri më 2025 me të drejtë shtyrje.

dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Sipërfaqja ku do të grumbullohet minerali është e varfër në bimesi dhe rrjedhimisht proceset ekologjike janë minimale dhe të kufizuara. Disa procese që lidhen me shumë me shqetësimet dhe cilësinë e mjedisit, do të ushtrojnë ndikimet e tyre në botën e gjallë sidomos do të mbajnë larg zonës disa lloje shtazore. Objekti është i distancuar nga qendrat e banuara, kështu që rritja e nivelit të zhurmave nuk do të krijojë probleme për banorët, vetëm për faunën. Gjithsesi operacionet e punës do të jenë të limituara në kohë.

Sasia e gazeve NO₂ dhe SO₂ që do të shkarkohet është standard i teknologjisë së automjeteve që do të përdoren gjatë punimeve të parashikuara do të jetë e limituar në kohë dhe nuk do të ketë ndikime në fshatrat përreth. Sipërfaqja e marrë në përdorim nuk do të ndryshojë destinacionin e sajë për asnjë arsye.

Sic u theksua dhe me sipër ky aktivitet do të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqes së kontrates së qerases e bërë ndërmjet paleve.

e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Plani i Rehabilitimit synon që në përfundim të zbatimit të tij të realizojë me sukses :

- Stabilizimin fizik të sipërfaqes së prekur nëpërmjet masave që do të përshkruhen më poshtë
- Punimet biologjike duke realizuar mbjellje të bimësisë së tapetit stabilizues (barishtore me rrënjë xhufkore) si dhe fidanëve
- Zhvillimin e proceseve natyrore të cilat dallohen qartë nëpërmjet indikatorëve abiotikë dhe biologjikë dhe evolujnë me stadin e zhvillimit të riaftesimit (sukcesionet biologjike)

- Maturimin e procesit të rehabilitimit dhe përdorimin e sipërfaqes.

Aktiviteti i shesh grumbullimit të mineraleve si aktivitet vepron në sipërfaqe. Pjesa e relievit ku do të zbatohet aktiviteti është e varfer nga mungesa e bimësisë. Në përfundim të aktivitetit do të duhet që të transformohen sipërfaqet e dëmtuara në një reliev të ri natyror, në një sipërfaqe në formën e sotme por të mbuluar nga vegetacioni, dhe në terene të gjelbëruara.

- Sistemimin në sipërfaqen egzistuese ku do të zhvillohet zbulimi nepermjet mbjelljes së pemëve për të rritur kohezionin e saj pasi të ketë përfunduar puna;
- Hapja e gropave ku do të mbillen fidanat dhe mbushjen e tyre me dherra vegjetale;
- Mbjelljen e sipërfaqeve të krijuara si më sipër dhe sipërfaqeve të reja në teritorin e zones me pemë natyrore dhe barishte të ndryshme;
- Mirembajtjen e sipërfaqeve të mbjella

Masat rehabilituese

- *Punimet e sistemimit të dheut që do të grumbullohet gjatë aktivitetit*

Masa e dheut gjeneruar nga aktiviteti do të sistemohet për t'u përdorur për rehabilitimin e mëvonshëm. Dheu do të ngjishet dhe mbulohet me shkurreta e bimë të tjera.

- *Sistemimi i dheut*

Dheu i grumbulluar do të sistemohet mbi sipërfaqen e përdorur, për sistemim do të merret dhe edhe nga jashtë objektit, Kjo me qëllim që të krijohet një shtrat i thellë toke në çdo shkallë për të mundësuar zhvillimin e bimësisë heterogjene dhe për të ofruar kushtet e duhura fiziko-kimike për mbështetjen e botës së gjallë. Në skajin fundor të çdo shkalle do të ndërtohet një mur i thatë guri i cili do të shërbejë si brez mbrojtës ndaj erozionit të shiut dhe do të ruajë masën e dheut. Masa e dheut që do të hidhet në sheshin e shkallës më pas do të sheshohet, ngjishet dhe nivelohet me mjete të posaçme nga stafi i subjektit. Paralel me sistemimin e dheut do të hidhet pleh organik i cili do të përzihet me masën e dheut (vlerat dhe roli i plehut organik janë të shumta duke filluar nga përmirësimi i cilësive fizike të tokës deri në çlirimin e lëndës ushqyese dhe mbështetjen e mikroganjizmave. E veçanta e përdorimit të plehut organik këtu është që ai do të krijojë kushte për zhvillimin e mikro dhe mezofaunës së tokës e cila zakonisht strehohet në të dhe do të pasurojë tokën me lloje). Në përfundim të sistemimit të dheut në shkallë do të hapen kanale të vegjël të cilët do të vishen me gurë të përmasave të duhura që të mundesohet drenazhimi i masës së dheut dhe lëvizja e ujërave të tepërta në kohë me reshje me qëllim që të mos rrezikohet dëmtimi i sheshit dhe zhvendosja e dheut në shkallën e poshtme. Pasi të jetë bërë rrethimi perimetrik i sheshit të shkallës me gurë dhe sterile, volumi i dheut që është hequr gjatë punimeve të zbulimit të shkallës të mos dëmtohet dhe të mbillet në fazën e punimeve biologjike në shkallë. Për të siguruar stabilizim më të mirë fizik të volumit të dheut në sheshin e shkallës do të vendosen në mënyrë të çrregullt gurë dhe sterile të përmasave të ndryshme që do të luajnë rolin e bërthamave lidhëse të hapsirës dhe dheut. Kjo do të shërbejë për të rritur rezistencën e masës së dheut nga erozioni si dhe do të lehtësojë formimin e strukturës së dheut duke i dhënë tiparet e një toke.

- *Punimet e maturimit të shtratit të dheut*

Para se të realizohet mbjellja e shtratit me llojet që do të përzgjidhen nga subjekti në bashkëpunim me Agjensinë Rajonale të Mjedisit dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor në rreth, është e nevojshme që shtrati i dheut të maturohet në mënyrë që të ofrojë kushtet e përshtatshme për mbirjen e farave dhe fidanëve. Gjatë kësaj periudhe kohore masa e dheut do të plerohet me pleh organik dhe do të punohet me bel. Në përfundim, mbasi të bëhet testimi i shtratit të dheut për filtrimin e ujit, strukturën e ajrosjes, stabilitetin strukturor dhe fizik dhe sidomos për aftësinë ujëmbajtëse do të përgatitet për mbjellje.

- *Realizimi i mbjelljes së “tapetit të gjelbër” të sheshit të karrierës*

Ky operacion do të realizohet menjëherë pas sistemimit–nivelimit të masës së dheut mbi sheshin e shkallës. Mbas ngjeshjes, nivelimit dhe hapjes së kanaleve kullues – drenazhues sipërfaqja e sheshit të shkallës do të shkrihet me krehër dhe do të mbillet me farë bari. Kjo bimësi duke qenë me sistem rrenjor xhufkor do të luajë rolin e stabilizuesit biologjik të masës së dheut në fazat e para të riaftësimit të tokës dhe fillimit të zhvillimit të proceseve fillestare të formimit të strukturës së tokës dhe raporteve ajër/ujë të agragateve tokësore dhe poreve. Në këtë fazë mund të kryhet një mulcirim modest i sipërfaqes së mbjellë me një shtresë të hollë plehu organik dhe mbulesë vegjetale.

- *Mbjellja e fidanëve dhe bimësisë shkurre*

Ky operacion do të bëhet mbas një periudhe kohore të në mënyrë që masa e dheut të sistemuar mbi sheshin e shkallës të jetë stabilizuar dhe të ketë fituar cilësitë e nevojshme për zhvillimin e bimësisë shkurre dhe fidanëve. Mbjellja e bimësisë autoktone në sipërfaqen e shfrytëzuar më parë do të bëjë të mundur stabilizimin e zonës së degraduar, mbrojtjen nga erozioni si dhe rregullimin e pejsazhit të zonës. Në këtë zonë është menduar të mbillen bimë autoktone, të cilat kanë përparësi pasi e kanë më të lehtë të përshtaten. Llojet që do të mbillen do të jenë akacia ose pisha. Mbjellja do të bëhet me fidanë të trajtuar më parë në fidanishte për një periudhë 2-vjeçare. Për të arritur qëllimin shoqëria mbetet e angazhuar të bëjë çdo investim dhe të marrë masat e përcaktuara në lejen e mjedisit për të realizuar rehabilitimin e objektit.

- *Rehabilitimi i tokës*

Per rehabilitimin e tokës, do të shfrytëzohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerre dhe do të plotësohet me 30 cm dhe’ (toke) të pasur me pleh. Nëse do të nevojitet stabilizimi i ketij dheu një pjesë të faqes së pjerrët do të bëhet me trungje të ngulura në toke me thellesi mbi 30 cm, dhe mulciritimi do të jetë i thatë dhe me kashte, gërthe të bimeve të zonës dhe dege. Mulciritimi do të shërbejë, si për uljen e humbjeve të farnave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe për uljen e aktivitetit erodikpersakohe vegjetacioni është i pazhvilluar mirë.

Mbjelljet do të kenë renditjen më largësi fidanesh çdo 8 metra, gjë që do të japë një kurorë dendësi mjaft të mirë teritorit, dhe lejon dritesimin për vetëritjen dhe zhvillimin e bimeve natyrore.

Kujdesi për punimet rehabilituese nga ana e shoqërisë do të vazhdojë deri në mbarimin përfundimtar të punimeve.

Duke konsideruar sipërfaqet e shesheve që zënë punimet e projektuara , në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet e rehabilitimit:

ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

Gjatë zbatimit të projekteve në terren duhet të mbahen në konsideratë mbrojtja e mjedisit dhe standartet mjedisore si dhe të aplikohen masa konkrete. Çdo zbatim projekti duhet të shoqërohet me planin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shmangien e dëmeve mjedisore të panevojshme dhe të riparueshme. Masat për mbrojtjen e mjedisit duhet të planifikohen dhe zbatohen gjatë operacioneve me ndikim në mjedis si në fazën e përgatitore ashtu edhe atë të shfrytëzimit të vendburimit. Në këtë seksion do të trajtohen masat kryesore për mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e ndikimeve negative të identifikuara në seksionin paraardhës. Masat e propozuara lidhen me fazat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- *Masat që do të merren për zbutjen e ndikimit*

Ndikimet mjedisore të karrierës do të zvogelohen duke zbatuar me korrektesë teknikat e mëposhtme:

- Piktetimi i sakte të sipërfaqes së shfrytëzimit dhe operim vetëm brenda saj,
- Kontrolli i pluhurave përmes lagës së zonës së punës dhe mbulimit të kamioneve gjatë transportit,

- Kontrollin e dherave te gjeneruara dhe sistemimin e tyre me ane te kompaktesimit te dherave dhe mbjelljes se shkurreve qe do te dalin nga pastrimi dhe hapja e karrieres me qellim rivegetacionin e shkalleve,
 - Hapjen e kanaleve te nevojshem per te drejtuar ujerat e shiut dhe erozionin,
 - Kontroll teknik i mjeteve te punes per te parandaluar rrjedhjet e karburantit
- *Masat e zbutjes se ndikimit ne fazen e pergatitjes per shfrytezim te objektit*

Masat per mbrojtjen e tokes

Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
Shqetesim i shtreses se tokes per shkak te ndertimit te tshansheve	Sasia e dheut mund te sistemohet pergjate rruges dhe te perdoret per qellime rehabilitimi ne faza te ndryshme te shfrytezimit ose per rehabilitimin e rrugeve dhe siperfaqeve te demtuara ne perfundim te shfrytezimit te minieres.
Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e automjeteve te transportit si kamione etj.	Per parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes do te shfrytezohen vendet e caktuara
Erozion siperfaqesor ne mot me reshje	Do te piketohen dhe hapen kanalet e drenazhimit ne siperfaqe. Pergjate segmenteve rrugore ne varesi te terrenit dhe kushteve te tokes do te hapen kanale anesore qe do te ndalim forcen gerryese te ujrave te reshjeve, ndersa pergjate perimetrit te sheshit te depozitimit te mineralit do te hapen kanale perimetrike kufizuese qe do te frenojne gerryerjen dhe transportin e tokes sipas gradientit te pjerrtise nga ujrat siperfaqesore. Ne pjese te vecanta do te shihet mundesia e mbjelljeve te fidaneve pyjore te pershtatshem per zonen fitoklimatike.
Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes	Makinerite e shfrytezimit dhe transportit do te kontrollohen per gjendjen e tyre teknike dhe nese konstatohen pjese te amortizuara qe mund te rrjedhin lubrifikante do te zevendesohen me te reja. Ne rast te ndonje aksidenti dhe rrjedhjeve aksidentale te lendeve ndotese ne mjedis do te merren masa per pastrimin e menjehershem te tokes se ndotur e cila do te depozitohet ne nje kazan te posatshem metalik ose prej betoni per t'u djegur me pas

Masat për mbrojtjen e ajrit

Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
Emetime te pluhurit, zhurmes, gazeve, aromave dhe vibracione	Manikerite duhet te mirembahen teknikisht qe zhurma e tyre te jete vetem ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet te perdoren me eficence dhe te minimizohet koha gjate se ciles mbahen ndezur motoret. Skapamentot duhet te kene ne gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjike te kapjes se grimcave (skapamentot e makinerive kane nje jastek te posatshem per kete gje). Do te perdoret nafte me permbajtje te ulet sqfuri. Transporti i materialeve te behet me mjete te pastra nga balta dhe te mbuluara nese rruget kalojne prane ose neper qendrat e banuara. Te menjahet renia e borive te automjeteve nga shoferet per te mos krijuar zhurme dhe stres tek banoret. Qarkullimi i kamioneve ne qendrat e banuara te behet me shpejtesi te ulet gje qe shmang jo vetem aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.

Masat për mbrojtjen e pejsazhit

Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
Ndikime ne pejsazh dhe topografine e relievit	Gjate shfrytezimit nuk duhet te demtohen siperfaqe te panevojshme si pasoje e mosplanifikimit te sakte apo e neglizhences se punetoreve qe mund te presin peme apo te shkaktojne zjarre dhe demtojne pejsazhin dhe bimesine e zones

Masat për mbrojtjen e biodiversitetit

Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
Ndikime ne faune	Shoferet do te udhezohen te bejne kujdes gjate transportit ne zona pyjore per te mos shtypur kafshe qe mund te jene ne mes te rruges. Shoferet duhet te spostojne kafshet pastaj te vijojne udhetimin

Masat për administrimin e mbetjeve urbane

Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor	Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet do te grumbullohen neper thase te posatcem dhe do te transportohen drejt drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal. Gomat dhe vaji lubrifikant te perdoruar do t'u jepen subjekteve qe merren me riciklimin e tyre dhe qe aktualisht operojne edhe ne Shqiperi (Ministria e Mjedisit posedon nje liste te subjekteve riciklues)

f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Gjate zhvillimit të aktivitetit në këto objekt nuk do të ketë ndikime në mjedisin ndërkufitar të projektit

Pas mbylljes së këtij aktiviteti me masat që shoqëria do të marrë për rehabilitimin e mjedisit, do të ketë ndikime pozitive në peisazhin e sipërfaqes së shfrytëzuar dhe në zhvillimin e flores.

g) Mbetjet që gjenerohen gjatë funksionimit të aktivitetit

Mbetjet që gjenerohen nga zhvillimi i këtij aktiviteti janë dhera e nxierra nga punimet dhe mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti njerezor.

Mbetjet që gjenerohen nga zhvillimi i këtij aktiviteti dhera e dala nga punimet dhe gjatë sistemimit të mineralit. Pjesa më e madhe e tyre do të përdoret për mbushjen e hapësirave dhe zonave të shfrytëzuara ndërsa një pjesë e vogël do të depozitohen në sheshet e përcaktuara në studimin teknik ekonomik dhe projektin e shfrytëzimit. Ato gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti mund të përdoren si materialet për sistemimin e rrugëve dhe transheve etj..

Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetësor i punësorëve apo ambalazhet do të grumbullohen nëpër thasë të posaçshme dhe do të transportohen drejt qendrave më të afërta të banuara për menaxhim nga sektoret përkatës të pushtetit lokal. Gomat dhe vajet lubrifikantë të përdorur do të japin subjekteve që merren me riciklimin e tyre dhe që aktualisht operojnë edhe në Shqipëri (Ministria e Mjedisit posedon një listë të subjekteve riciklues).

PERGATITI

“D.E.A. PROJEKT” SH.P.K.

licensuar nga Q.K.B. për shërbime ekspertize profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.

nr. license LN-4030-11-2017

EKSPERT MJEDISOR

GEZIM DAUTI